



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 2986/Prot.
1

Tiranë, më 15 04.2015

UDHËZIM

Nr. M/1, datë 15 04.2015

PËR

**BOTIMIN E TEKSTEVE SHKOLLORE TË REJA
PËR VITIN SHKOLLOR 2015-2016**

Në mbështetje të neneve 45 dhe 47 të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.02.2010 “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. KËRKESA PËR TEKSTE SHKOLLORE TË REJA

I.1. Për vitin shkollor 2015-2016 shpallet konkursi për:

- a) Tekstet e klasës së parë të arsimit fillor:
 1. Matematikë
 2. Dituri natyre
 3. Edukim për shoqërinë
 4. Edukim fizik.
- b) Tekstet e klasës së gjashtë të arsimit të mesëm të ulët:
 1. Gjuhë shqipe
 2. Gjuhë e huaj e parë

3. Gjuhë e huaj e dytë
 4. Matematikë
 5. Fizikë
 6. Biologji
 7. Qytetari
 8. Histori
 9. Gjeografi
 10. Muzikë
 11. Art pamor
 12. Edukim fizik
 13. Teknologji
 14. TIK.
- c) Tekstet e historisë së Shqipërisë:
1. Histori 4
 2. Histori e shqiptarëve 9
 3. Histori e shqiptarëve 12.

I.2. Hartimi i teksteve shkollore të reja të bëhet në përputhje me kërkesat e programeve të reja mësimore 2015-2016 dhe standardet për tekstet shkollore.

- a) Tekstet shkollore të reja “Matematikë 1”, “Dituri natyre 1”, “Matematikë 6”, “Fizikë 6” dhe “Biologji 6” të jenë përkthim i teksteve shkollore të shtëpive botuese “Oxford University Press” dhe “Pearson”, apo i çdo shtëpie botuese që është pjesë e tyre.
- b) Tekstet shkollore të reja “Gjuhë e huaj e parë” (Anglisht 6, Frëngjisht 6, Italisht 6, Gjermanisht 6) dhe “Gjuhë e huaj e dytë” (Anglisht 6, Frëngjisht 6, Italisht 6, Gjermanisht 6) të paraqiten në versionin e tyre origjinal, botim i shtëpive botuese të huaja.
- c) Tekstet shkollore të reja “Histori 4”, “Histori e shqiptarëve 9” dhe “Histori e shqiptarëve 12” të hartohen mbështetur në:
 - c.1. Rekomandimin 15 (2001) të Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare të Këshillit të Europës për mësimin e historisë në Europën e shekullit XXI.
 - c.2. Rekomandimin 1880 (2009) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës për mësimin e historisë në zonat në konflikt dhe pas konfliktit që, ndër të tjera, pranon dhe kërkon ngritjen e rolit të historisë për rritjen e mirëkuptimit, tolerancës dhe besimit ndërmjet individëve dhe popujve.
 - c.3. Angazhimet e shtetit shqiptar që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare për formimin e njohurive të reja dhe të kompetencave për të nxëniet për jetën dhe gjatë gjithë jetës, në kuadër të programeve mësimore të reja të arsimit parauniversitar.
- d) Teksti shkollor i ri që paraqitet për konkurrim, të përputhet me kriteret e përcaktuara në rregulloren e konkursit.

I. AFATET KOHORE TË ZHVILLIMIT TË KONKURSIT

Shpallja e konkurrimit:	20 prill 2015
Dorëzimit i teksteve shkollore:	18 qershor 2015
Shpallja e fituesve:	30 qershor 2015
Lidhja e kontratave MAS - Botues:	10 korrik 2015
Shpërndarja dhe shitja e teksteve:	1 shtator - 14 shtator 2015

II. PJESËMARRJA NË KONKURS

1. Çdo shtëpi botuese dhe / ose distributor ka të drejtë të marrë pjesë në konkursin për tekstet shkollore të reja, nëse e ushtron veprimtarinë e saj/tij në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Nuk pranohet pjesëmarrja në konkurs e shtëpive botuese dhe / ose distributorëve që kanë shkëlur kontratën e nënshkruar me MASH/MAS-in.
3. Udhëzimi, programet mësimore dhe çdo material tjetër shpjegues për të interesuarit publikohen në faqen zyrtare të MAS: www.arsimi.gov.al.
4. Shpenzimet e konkursit përballohen nga konkurruesi.

III. RUAJTJA E FSHEHTËSISË SË DOKUMENTACIONIT PËR KONKURRIM

Dokumentet që do të paraqesë çdo shtëpi botuese dhe / ose distributor në konkurs, mënyra e paraqitjes dhe e dorëzimit të tyre dhe kriteret e ruajtjes së fshehtësisë përcaktohen në Rregulloren e konkursit.

IV. KONFLIKTI I INTERESIT

1. Punonjësit e MAS-it dhe të institucioneve të varësisë, si dhe recensuesit, nuk mund të jenë autorë teksti, botues, pronarë shtypshkronje, që merr pjesë në procesin e hartimit të teksteve për vitin shkollor 2015-2016.
2. Personat të cilët janë autorë tekstesh të katalogut të teksteve shkollore të reja, nuk mund të jenë recensues.
3. Shtëpitë botuese dhe / ose distributorët duhet të shmangin çdo konflikt interesi të dukshëm apo të fshehur sipas legjislacionit në fuqi.

V. ÇMIMI I TEKSTEVE SHKOLLORE TË REJA

1. Botuesi propozon çmimin e tekstit shkollor të ri që paraqet në konkurs.
2. Ministria e Arsimit dhe Sportit vlerëson çmimin e propozuar dhe vendos çmimin për çdo tekst shkollor që do të miratohet për përdorim në institucionin arsimor.

VI. VLERËSIMI DHE MIRATIMI I TEKSTEVE SHKOLLORE TË REJA

Vlerësimi dhe miratimi i teksteve shkollore të reja të bëhet sipas treguesve dhe aspekteve të Standardeve për tekstet shkollore (të ndryshuara) dhe Rregullores së konkursit.

Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar dhe Komisioni i Vlerësimit të Teksteve Shkollore të reja.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

LINDITA NIKOLLA



MINISTËR

